



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE

УСТАВНИ СУД

CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 21 tetor 2021

Nr. ref.:RK1871/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI 38/20

Parashtrues

Mirko Samardžić

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të
Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në
lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit AC-I-17-0074-A123
të 8 tetorit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Mirko Samardžić nga fshati Jazhincë, komuna e Shtërpçës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit AC-I-17-0074-A123 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit i DHPGJ-së), i 8 tetorit 2019, të cilin e ka pranuar më 31 tetor 2019.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, përmes të cilit pretendohet se janë shkelur të drejtat dhe liritë e parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës], 47 [Kërkesa individuale] dhe 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullit 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 21 shkurt 2020, parashtruesi e dorëzoi kërkesën përmes postës në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 24 shkurt 2020, Kryetarja caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
7. Më 6 mars 2020, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe në të njëjtën kohë i kërkoj atij që ta plotësojë formularin zyrtar të kërkesës dhe të dorëzojë në Gjykatë vendimin e Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, i cili është objekt i kontestimit.
8. Më 24 mars 2020, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë formularin e plotësuar të Gjykatës. Ai gjithashtu dorëzoi në Gjykatë edhe aktgjykimin e Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, të cilin e konteston në Gjykatë.
9. Më 26 qershor 2020, Gjykata njoftoi Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së për regjistrimin e kërkesës.
10. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe Rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, Gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin 4 të Rregullit 12

të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës nr. KK-SP 71-2/21, u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, më 26 qershor 2021.

11. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe Rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së Punës, gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.
12. Më 27 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, përmes Vendimit Nr. KI38/20, caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi si gjyqtare raportuese në vend të gjyqtarit Bekim Sejdiu pas dorëheqjes së tij.
13. Më 31 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës, Arta Rama-Hajrizi, me Vendimin nr. KK 160/21 përcaktoi që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani të emërohej kryesuese në Kolegjet shqyrtuese në rastet ku ajo ishte emëruar anëtare e Kolegjit, përfshirë rastin aktual.
14. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin 4 të Rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës nr. KK-SP 71-2/21, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtarës së Gjykatës Kushtetuese.
15. Më 22 shtator 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

16. Bazuar në pretendimet në shkresat e lëndës, parashtruesi i kërkesës deklaroi se ai kishte qenë në marrëdhënie pune në Ndërmarrjen Shoqërore "Sharr" nga Hani i Elezit (në tekstin e mëtejme: NSH Sharr). Parashtruesi i kërkesës themeloi marrëdhënien e tij të punës me NSH Sharr më 13 korrik 1992, në të cilën, sipas pretendimeve të tij ka punuar deri në qershor 1999.
17. NSH Sharr përbëhej nga disa ndërmarrje të cilat ishin privatizuar dhe shitur nga Agjencia Kosovare e Privatizimit në disa faza, përkatësisht,
 1. Shitja me spin-off të rregullt e ndërmarrjes së re "Lepenci" në Kaçanik është kryer më 08.03.2004.
 2. Shitja e ndërmarrjes së re "Silkapor" në Doganoviq është kryer më 16.03.2005.
 3. Shitja e ndërmarrjes së re "Shar-Salonit" në Han të Elezit është kryer më 29.04.2010.
 4. Shitja e ndërmarrjes së re "Sharr Cem" në Han të Elezit u bë më 9 dhjetor 2010, ndërsa komercializimi ishte kryer më 13.07.2000.

18. Më 7, 8 dhe 9 qershor 2012, Agjencia Kosovare e Privatizimit publikoi listën përfundimtare të punëtorëve me të drejtë në 20% të privatizimit të NSH Sharr, në listën e përmendur të punëtorëve nuk ishte emri i parashtruesit të kërkesës.
19. Më 26 qershor 2012, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në DHPGJS kundër Agjencisë Kosovare të Privatizimit, duke kërkuar që emri i tij të përfshihet në listën përfundimtare të punëtorëve që kanë të drejtë në 20% të privatizimit të NSH Sharr.
20. Më 31 janar 2017, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së, me Aktgjykimin C-II.-12-0023, refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar dhe me këtë refuzoi kërkesën e parashtruesit për të përfshirë emrin e tij në listën përfundimtare të punonjësve që kanë të drejtë në 20% të privatizimit të NSH Sharr.
21. Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së arsyetoi se parashtruesi i kërkesës *“nuk i siguroi Gjykatës prova të mjaftueshme në lidhje me rastin. Prandaj, Gjykata vlerëson se ankuesi nuk i plotëson kërkesat e nenit 10.4 të Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 203/13, pasi që gjatë privatizimit ai nuk ishte regjistruar si punonjës i NSH-së, prandaj nuk ka bazë për ta përfshirë atë në listën e punëtorëve me të drejta legjitime. Ankuesi ofroi librezën e punës e cila ishte hapur që nga 01.06.1997. Pas asaj kohe, Gjykata nuk ka asnjë provë që ankuesi ka punuar në NSH-në e lartpërmendur. Ankuesi nuk ankohet se ai ishte viktimë e diskriminimit. Prandaj, ankesa u refuzua si e pabazuar”*.
22. Më 6 mars 2017, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Kolegjin e Apelit kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, duke deklaruar se në bazë të, *“provave e dorëzuara, lehtë mund të vihet në përfundim që në ndërmarrjen e përmendur ka themeluar marrëdhënie të punës që më 13.02.1992 dhe në të njëjtën ka punuar në vazhdimësi deri në fillim të ngjarjeve të luftës në Kosovë, respektivisht deri në mars të vitit 1999, kur për shkak të rrethanave të luftës ka qenë i pamundësuar të kryejë punët dhe se ai nuk e kishte mbyllur librezën e tij të punës, ankuesi gjithashtu deklaroi se diskriminimi mbi baza etnike pas vitit 1999 në lidhje me punonjësit e komunitetit serb dhe kombësive të tjera ishte një fakt i njohur botërisht dhe përgjithësisht. Si provë ai paraqiti një kopje të deklaratës së 10 tetorit 2001 dhe një njoftim të bërë nga Avokati i Popullit”*.
23. Më 8 tetor 2019, Kolegji i Apelit nxori Aktgjykimin AC-I-17-0074-A123, përmes të cilit hodhi poshtë ankesën e parashtruesit të kërkesës si të papranueshme dhe vërtetoi në tërësi Aktgjykimin e shkallës së parë të Kolegjit të Specializuar.
24. Në këtë aktgjykim, Kolegji i Apelit arsyetoi, ndër të tjera, se: *“nuk është kontestues fakti që ankuesi ka themeluar marrëdhënie të punës dhe ka qenë punonjës i NSH “Sharr” nga Hani i Elezit, por Kolegji i Apelit konstaton se punonjësi nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme se ishte punonjës i saj në kohën e privatizimit, i njëjti nuk ankohet se ai ishte viktimë e diskriminimit si arsye për vazhdim të marrëdhënies së tij të punës. Pretendimi se ankuesi ishte viktimë e diskriminimit si arsye për mos vazhdimin e marrëdhënies së punës së tij u paraqit në Kolegjin e Apelit dhe si i tillë është i pabazuar, për shkak të faktit se nëse ekzistonte diskriminimi si arsye për mos vazhdimin e*

marrëdhënies së punës pas vitit 1999, ishte i njohur në kohën e parashtrimit të ankesës në shkallën e parë, atëherë ky pretendim është dashur të paraqitej në Kolegjin e Specializuar ose të jepeshin arsye të bazuara nga ankuesi pse ky fakt nuk u paraqit në shkallën e parë, siç parashihet në nenin 180 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, kështu që ankuesi nuk i plotëson kushtet për të qenë në listën e pagave në kohën e privatizimit të NSH-së, një kusht i paraparë në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/13, neni 10.4, në mënyrë që të njihej e drejta e tij për t'u përfshirë në listën përfundimtare me të drejta legjitime në mënyrë që të përfitojë nga shitja një pjesë të të ardhurave të NSH-së”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

25. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit AC-I-17-0074-A123, të 8 tetorit 2019, në lidhje me Aktgjykimin e Kolegjit të Specializuar C-II.-12-0023 të 31 janarit 2017, janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], si dhe nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.
26. Parashtruesi i kërkesës arsyeton shkeljen e nenit 24 të Kushtetutës, “... është plotësisht jo e logjikshme dhe e padrejtë që në të njëjtën situatë juridike në të cilën janë gjendur të gjithë të punësuarit të cilët vijnë nga komuniteti kombëtar joshqiptar, trajtohen jo në mënyrë të barabartë, e kjo është që të gjithë kemi punuar deri në fillim të ngjarjeve të luftës të marsit të vitit 1999 e më vonë askush, për shkaqe të sigurisë dhe diskriminimit, kështu që gjysma e ankesave miratohet e gjysma tjetër refuzohet, me çka në përgjithësi cenohet parimi i barazisë dhe gjykimin të drejtë [...] kështu që është e padrejtë që një grup i ankesave të të punësuarve serbë të miratohet në bazë të diskriminimit kurse grupi tjetër të refuzohet për shkak të dështimit të pretenduar për të dëshmuar diskriminimin. Shumica e të punësuarve në ndërmarrjen lëndore ka qenë nga komuna e Shtërpçës dhe të gjithë ne kemi qenë në të njëjtën situatë faktike juridike dhe që në këtë rast obligimi i gjykatës ka qenë që të na trajtojë njëjtë në pikëpamje të të drejtave tona themelore e veçanërisht të drejtave të cilat burojnë nga marrëdhënia e punës”.
27. Parashtruesi i kërkesës pretendon gjithashtu shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, por nuk arsyeton dhe as nuk shpjegon se si ka ardhur deri te shkelja e këtij neni, por konsideron se shkelja e nenit 31 të Kushtetutës ishte për shkak të trajtimit të pabarabartë ose shkeljes së parimit të barazisë, të garantuar me nenin 24 të Kushtetutës.
28. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të konstatojë shkelje të neneve 24 dhe 31 të Kushtetutës, të anulojë vendimet e kontestuara dhe ta kthejë rastin në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim, dhe në këtë mënyrë t'i mundësojë parashtruesit të kërkesës të realizojë të drejtat e tij.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

29. Gjykata fillimisht shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të parapara me Kushtetutë, të specifikuara më tej me Ligj dhe të përcaktuara me Rregullore të punës.

30. Në këtë drejtim, Gjykata iu referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

31. Gjykata i referohet më tej nenit 49 [Afatet] të Ligjit, i cili përcakton:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”.

32. Gjykata i referohet edhe nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili përcakton:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

33. Sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar që konteston aktin e autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin AC-I-17-0074-A123 e Kolegjit të Apelit, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu deklaroi të drejtat dhe liritë të cilat ai pretendoi se ishin shkelur, në pajtim me kushtet e nenit 48 të Ligjit dhe e dorëzoi kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

34. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton kushtet në bazë të të cilave Gjykata mund të shqyrtojë një kërkesë, duke përfshirë edhe kushtin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Rregulli 39 (2) parasheh në mënyrë specifike:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

35. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton që më 7, 8 dhe 9 qershor 2012, AKP-ja publikoi listën përfundimtare të punëtorëve që kishin të drejtë në 20% nga privatizimi i NSH Sharr. Parashtruesi i kërkesës kontestoi këtë vendim në Kolegjin e Specializuar të DHPGJS-së, por, i njëjti me Aktgjykimin [C-II.-12-0023] të 31 janarit 2017, refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar dhe vërtetoi aktvendimin e Autoritetit të Likuidimit, duke theksuar, ndër të tjera, që parashtruesi i kërkesës nuk ishte regjistruar si punonjës i NSH-së gjatë privatizimit. Parashtruesi i kërkesës përfundimisht iu drejtua

Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, megjithatë, sipas aktvendimit të Kolegjit të Apelit, parashtruesi i kërkesës nuk ofroi dëshmi të mjaftueshme se ai ishte punonjës i saj në kohën e privatizimit. Pretendimi se ai ishte viktimë e diskriminimit ka qenë i njohur për parashtruesin e kërkesës edhe gjatë parashtrimit të ankesës në Kolegjin e Specializuar të DHPGJS-së, por parashtruesi i kërkesës nuk e ngriti këtë çështje në Kolegjin e Specializuar të DHPGJS-së, dhe as nuk ofroi ndonjë arsyetim në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së pse ky fakt nuk u paraqit në shkallën e parë, ashtu siç parashihet me nenin 180 të Ligji për Procedurën Kontestimore.

36. Parashtruesi i kërkesës konteston në Gjykatë aktvendimin e Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, duke pretenduar shkelje të nenit 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, por duke e përqendruar argumentimin e tij në paligjshmëri, përkatësisht në vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimin e gabuar të dispozitave të ligjit të aplikueshëm.
37. Në lidhje me pretendimet e mësipërme, Gjykata konsideron (i) që parashtruesi i kërkesës e ndërtoi rastin e tij në baza të ligjshmërisë, përkatësisht në vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimin e gabuar të ligjit nga gjykatat e rregullta; si dhe (ii) që parashtruesi thjesht numëron dhe përshkruan përgjithësisht përmbajtjen e dispozitës kushtetuese, por nuk tregon saktësisht se si është shkelur kjo dispozitë në rastin e tij.

(i) Shkeljet e pretenduara të nenit 24 të Kushtetutës

38. Në lidhje me këto pretendime të parashtruesit të kërkesës, Gjykata fillimisht i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së e cila thotë se “*diskriminimi do të thotë trajtim ndryshe, pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, të personave në situata relativisht të ngjashme*” (shih: *Willis kundër Mbretërisë së Bashkuar*, paragrafi 48 i Aktgjykimit të GJEDNJ-së, të 11 shtatorit 2002; *Bekos dhe Koutropoulos kundër Greqisë*, paragrafi 63, Aktgjykimi i GJEDNJ-së, i 13 marsit 2006, shih, gjithashtu, rastin e Gjykatës KI166/20, parashtrues: *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri i 5 janarit 2021, paragrafi 44).
39. Më tej, Gjykata rikujton që në mënyrë që pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me shkeljen e të drejtës për mosdiskriminim të jenë të suksesshme, ai, *inter alia*, duhet të dëshmojë se pozita e tij mund të konsiderohet e ngjashme me pozitën e një personi tjetër i cili ka pasur trajtim më të mirë (shih: *Fredin kundër Suedisë* (nr. 1), paragrafi 60, GJEDNJ, Aktgjykim i 18 shkurtit 1991, shih, gjithashtu, rastin e Gjykatës KI166/20, cituar më lart, paragrafi 45).
40. Sa i përket rastit konkret, Gjykata gjen se parashtruesi i kërkesës i vë në dukje pretendimet për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës në lidhje me trajtimin e pabarabartë. Duke i ndërlidhur pretendimet me rastin konkret, si dhe me garancitë dhe parimet e nenit 24 të Kushtetutës, Gjykata vëren se, në thelb, parashtruesi i kërkesës të gjitha pretendimet e lidhura me pohimet e tij, i sjellë në kontekstin e zbatimit dhe interpretimit të gabuar të së drejtës materiale.

41. Megjithatë, Gjykata gjithashtu vëren se parashtruesi i kërkesës, përveç pretendimit paushall *që në të njëjtën situatë juridike në të cilën janë gjendur të gjithë të punësuarit të cilët vijnë nga komuniteti kombëtar joshqiptar, trajtohen jo në mënyrë të barabartë, [...] kështu që gjysma e ankesave miratohet e gjysma tjetër refuzohet, me çka në përgjithësi cenohet parimi i barazisë dhe gjykimin të drejtë*, nuk paraqiti asnjë provë që do të mund të dëshmonte se ka pasur me të vërtetë diskriminim, përkatësisht se është trajtuar ndryshe në raport me palën tjetër në një situatë të njëjtë ose të ngjashme, dhe kjo nuk rezulton as nga dokumentet e paraqitura në Gjykatën Kushtetuese.
42. Prandaj, Gjykata konsideron se pretendimet për trajtim të pabarabartë të parashtruesit të kërkesës janë paushalle, ndërsa arbitrariteti i mundshëm i gjykatave në këtë procedurë gjyqësore nuk është i dukshëm. Duke pasur parasysh të gjitha të lartcekurat, Gjykata konsideron se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të ndalimit të diskriminimit nga neni 24 i Kushtetutës janë qartazi (*prima facie*) të pabazuara.
43. Gjykata vëren se Kolegji i Apelit i arsyetoi parashtruesit të kërkesës se detyrimi i tij ligjor ishte ose ta ngrinte çështjen e diskriminimit në procedurën e shkallës së parë ose të paraqiste arsyen e bazuar pse ky pretendim nuk u paraqit në shkallën e parë, dhe duke pasur parasysh që parashtruesi i kërkesës nuk e bëri këtë, Kolegji i Apelit nuk u mor me këtë çështje.
44. Parashtruesi i kërkesës nuk arsyetoi ose nuk ofroi prova se pozita e parashtruesit të kërkesës mund të konsiderohej e ngjashme me pozitën e një personi tjetër që kishte pasur trajtim më të mirë (shih: *Fredin kundër Suedisë* (nr. 1), paragrafi 60, GJEDNJ, Aktgjykim i 18 shkurtit 1991, shih, gjithashtu, rastin e Gjykatës KI166/20, cituar më lart, paragrafi 49).
45. Rrjedhimisht, në këto rrethana, bazuar në sa më sipër dhe duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, Gjykata, duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e Gjykatës në rastet e ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton që parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar dhe nuk i ka mbështetur mjaftueshëm pretendimet e tij për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ.
46. Prandaj, Gjykata konkludon se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës, duhet të deklarohen të papranueshme si qartazi të pabazuara pasi që këto pretendime kualifikohen si pretendime që hyjnë në kategorinë e pretendimeve "*të pambështetura apo të paarsyetuara*" sepse parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar dhe nuk i ka mbështetur mjaftueshëm pretendimet e tij në lidhje me shkeljet e të drejtave të tij përkitazi me diskriminim, por thjesht citoi një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur. Rrjedhimisht, të njëjtat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

(ii) Përkitazi me pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës

47. I njëjti parim vlen edhe për pretendimet e parashtruesit të kërkesës në Gjykatë përkitazi me pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës. Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të Kushtetutës pa argumentuar dhe arsyetuar shkeljen e të njëjtave përmes Aktvendimit të kontestuar të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së (shih, ndër të tjera në këtë aspekt, rastin e Gjykatës nr. KI68/17, parashtrues, *Hysni Bytyqi*, Aktvendim për papranueshmëri i 4 qershorit 2018, paragrafi 32).
48. Gjykata në këtë aspekt dhe për më tepër, thekson se fakti i thjeshtë që parashtruesi i kërkesës nuk është i kënaqur me rezultatin e Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së apo vetëm përmendja e neneve të Kushtetutës dhe e instrumenteve tjera ndërkombëtare, nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë aspekt, rastin e Gjykatës KI136/14, *Abdullah Bajqinca*, Aktvendim për papranueshmëri i 10 shkurtit 2015, paragrafi 33).
49. Prandaj në këto rrethana, bazuar në si më sipër dhe duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtruesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, Gjykata duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton që parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar dhe nuk ka mbështetur mjaftueshëm pretendimet e tij për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë.
50. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe paragrafit (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 22 shtator 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Selvetë Gërxhaliu Krasniqi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani